VENDIM
Nr. 59, datë 25.11.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 36, DATË 6.9.2017, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME CËRRIK"

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe të rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 25.11.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: Mbi miratimin e projektvendimit "Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 36, datë 6.9.2017, 'Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Cërrik'",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Cërrik (UK Cërrik), me shkresën nr. 428 prot., datë 19.11.2019, të Entit Rregullator të ujit (ERRU), ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), dokumentacionin për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, të shoqëruar sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe rregullores së licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Cërrik për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.
3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Cërrik me vendimin nr. 36, datë 6.9.2017, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Cërrik", me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe të largimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Cërrik sh.a. z. Eneo Taçaj, ka mbaruar studimet e larta në Ekonomi, dega Ekonomia dhe e drejta, si dhe master për të drejtën civile.
5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Cërrik sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Cërrik është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR nr. 36, datë 6.9.2017, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Cërrik" bëhen këto ndryshime:

"Drejtues ligjor: z. Eneo Taçaj."

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani